



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, Universitet publik, me adresë
Rruga e Shkronjave, nr. 1, 20000 Prizren, Republika e Kosovës, i
përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani,

dhe

Cactus Education sh.p.k. me adresë në, Adresa: Rr. Bashkim Fehmiu
Arbëria 3 BC2/14 nr.4, 10000 Prishtinë, më poshtë referuar si
"Cactus Education" përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Vildane
Kelmendi

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të rregullojë kushtet e bashkëpunimit midis dy institucioneve, me qëllim të ofrimit të mundësive akademike të zgjeruara për studentët dhe stafin.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Ky bashkëpunim përfshinë njohjen reciproke të programeve, shkëmbimin e ligjëruesve dhe studentëve, zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta me interes edukativ dhe shkencor dhe çështjeve të tjera me interes të përbashkët, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:

- Seminare, tryeza pune, konferenca, takime profesionale;
- Ligjërata me ligjërues të rregullt dhe mysafirë, vendorë dhe ndërkombëtarë;

- Projekte të përbashkëta me partnerë vendorë dhe të huaj;
- Programe shkëmbimi të studentëve dhe ligjëruesve;
- Ofrimi i hapësirave, laboratorëve dhe pajisjeve për aktivitete të përbashkëta;

Neni 3

Përgjegjësitë specifike

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren dhe Cactus Education e caktojnë personin(ët) si përfaqësuesit e tyre përkatës për të koordinuar dhe menaxhuar aktivitetet sipas kësaj marrëveshje. Përfaqësuesit do të takohen sipas nevojës për të diskutuar mbi programet, bashkërendimin e programeve, shkëmbimin e ligjëruesve dhe studentëve si dhe çdo çështje tjetër me interes për të dyja palët.

Neni 4

Plotësimi dhe ndryshimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të plotësohet apo ndryshohet me përcaktimin reciprok të Palëve. Nëse njëra palë dëshiron të ndryshojë marrëveshjen, atëherë duhet ta njoftojë palën tjetër domosdoshmërisht me shkrim, duke përfshirë të gjitha detajet përkatëse. Amendamentet do të hyjnë në fuqi sapo secila palë ta njoftojë tjetrën me shkrim për pëlqimin e saj, në përputhje me ligjet, politikat, rregullat dhe rregulloret e saja.

Neni 5

Zgjidhja e konfliktit

Çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të lindë ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet ndërveprimit dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë.

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi nëse nuk ndërpritet nga asnjëra palë duke i dhënë palës tjetër një njoftim me shkrim, të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së planifikuar të përfundimit.



Çdo dispozitë e kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të dy palëve.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje palët pajtohen me kushtet të cilat janë cekur më lartë.

Prizren, 19.04.2024



Vildane Kelmendi , Drejtor
Ekzekutiv
Cactus Education



Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani,
Rektor
Universiteti "Ukshin Hoti"
,Prizren